



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · eëë.uni-pr.edu

**Fakulteti:** Bujqësisë dhe Veterinarisë

**Departamenti:** Bujqësia Urbane

**Programi studimor master:** Bujqësia Urbane

**NJOFTIM**

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se:

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja BSc. Donjeta Fazliu, me titull:

**“Ndikimi i praktikave dhe pajisjeve të prodhimit në sasinë dhe cilësinë e produkteve të përpunuara në fabrikat e vogla dhe ato industriale”,** ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 24/06/2026 deri me datë 01/07/2026.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Dr. sc. Mentor Thaqi, Prof. Asoc.
2. Dr. sc. Skender Kaçiu, Prof. Dr.
3. Dr. sc. Njazi Bytyqi, Prof. Asoc.

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonin te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Mentor Thaqi, përmes e-mail adresës [mentor.thaqi@uni-pr.edu](mailto:mentor.thaqi@uni-pr.edu).

Për të pasur një informacion paraparak më poshtë e gjeni një përmbledhje të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

## **Titulli i punimit master:**

# **NDIKIMI I PRAKTIKAVE DHE PAJISJEVE TË PRODHIMIT NË SASINË DHE CILËSINË E PRODUKTEVE TË PËRPUNUARA NË FABRIKAT E VOGLA DHE ATO INDUSTRIALE**

## **PËRMBLEDHJE**

Industria ushqimore paraqet një sektor të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe sigurimin e produkteve cilësore për konsumatorët. Zhvillimi i teknologjisë, përdorimi i pajisjeve moderne dhe automatizimi i proceseve të prodhimit ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë ushqimore dhe konkurrueshmërinë e produkteve të përpunuara.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e teknologjisë, pajisjeve moderne dhe automatizimit në cilësinë dhe performancën e prodhimit në ndërmarrjet përpunuese. Studimi fokusohet në perceptimet e menaxherëve, stafit administrativ dhe punëtorëve të prodhimit lidhur me nivelin e teknologjisë, automatizimin e proceseve, cilësinë e produktit, sigurinë ushqimore dhe konkurrueshmërinë në ndërmarrje.

Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori të strukturuar me shkallë dhe janë analizuar me programin IBM SPSS Statistics. Për analizimin e të dhënave janë përdorur statistikat përshkruese, Independent Samples T-Test, One-Way ANOVA dhe analiza e korrelacionit Pearson.

Rezultatet e hulumtimit treguan se ekziston një lidhje pozitive dhe statistikisht e rëndësishme ndërmjet nivelit të teknologjisë dhe automatizimit të proceseve të prodhimit. Analizat gjithashtu treguan se nuk ekzistojnë dallime statistikisht të rëndësishme ndërmjet grupeve sipas pozitës së respondentëve në lidhje me cilësinë e produktit, nivelin e teknologjisë dhe automatizimin.

Megjithatë, respondentët vlerësuan se përdorimi i pajisjeve moderne dhe teknologjisë së avancuar ndikon pozitivisht në organizimin e proceseve të prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve.

Në përgjithësi, rezultatet e studimit tregojnë se investimi në teknologji, pajisje moderne dhe automatizim paraqet një faktor të rëndësishëm për zhvillimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe rritjen e efikasitetit të proceseve të prodhimit.

**Master's thesis title:**

**THE IMPACT OF PRODUCTION PRACTICES AND EQUIPMENT ON THE QUANTITY  
AND QUALITY OF PRODUCTS PROCESSED IN SMALL AND INDUSTRIAL  
FACTORIES**

**SUMMARY**

The food industry represents an important sector for economic development and the provision of quality products for consumers. The development of technology, the use of modern equipment, and the automation of production processes directly affect the quality, food safety, and competitiveness of processed products.

The purpose of this study is to analyze the impact of technology, modern equipment, and automation on the quality and performance of production in processing enterprises. The study focuses on the perceptions of managers, administrative staff, and production workers regarding the level of technology, process automation, product quality, food safety, and competitiveness within enterprises.

The data were collected through a structured questionnaire using a Likert scale and analyzed using IBM SPSS Statistics software. Descriptive statistics, Independent Samples T-Test, One-Way ANOVA, and Pearson correlation analysis were used for data analysis.

The results of the study showed that there is a positive and statistically significant relationship between the level of technology and the automation of production processes. The analyses also showed that there are no statistically significant differences between respondent groups based on their position regarding product quality, technology level, and automation.

However, respondents evaluated that the use of modern equipment and advanced technology positively affects the organization of production processes and the improvement of product quality. Overall, the findings indicate that investment in technology, modern equipment, and automation represents an important factor for the development of production enterprises and the increase of production process efficiency.